

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCIME

NJOFTIME

Gjatë muajit gusht, Enti Rregullator i Energjisë ka filluar procedurat e licencimit për subjektet e mëposhtme:

1. "SELCA ENERGJI" shpk për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike.
2. "Joint Venture 2B 1979 dhe 2T shpk" për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, procedurë e cila u finalizua me vendimin Nr. 268 datë 11.09.2023.
3. "KESH" sh.a për rinovimin e licencës së shoqërisë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
4. "AYEN ENERGY TRADING" sha për rinovimin e licencave, në veprimtarinë e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike

Komuniteti i Energjisë publikon statusin e NECPs: Shqipëria kryeson vendet pjesmarrëse

Ecuria e Shqipërisë në projektin e Planeve Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (NECPs) të Komunitetit të Energjisë tregon përkushtimin e saj ndaj energjisë së qëndrueshme. Shqipëria ka bërë arritje të rëndësishme që ilustron angazhimin e saj, duke i dhënë përparësi burimeve të rinovueshme, duke ulur emetimet dhe duke nxitur bashkëpunimin rajonal për një të ardhme më të gjelbër. NECP-të shërbejnë si një udhërrëfyes për të arritur reduktimin e gazeve serrë, rritjen e investimeve në projektet e erës, diellit dhe hidroenergjisë, uljen e kostos dhe rritjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë në sektorin e energjisë.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE BORDI

Këtë muaj, Bordi i ERE-s ka zhvilluar pesë mbledhje, që kanë rezultuar në 21 vendimmarrje, ndër të cilat, licencimi i katër subjekteve në prodhimin e energjisë elektrike nga centrale fotovoltaike, një subjekti në tregtimin e energjisë elektrike si dhe miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2023 prej 15.33 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, por dhe vendime mbi çështje të brendshme të organizimit të institucionit. Gjithashtu, disa vendime të tjera janë dhe rinovimi i licencës së një shoqërie në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike; pranimi pjesërisht i kërkesave të shoqërive “Power Elektrik – Slabinjë” sh.p.k si dhe “Hidropower Elektrik” sh.p.k., mbi zgjatjen e afatit të vendimeve të Bordit të ERE përkatësisht nr. 166 dhe nr. 167, datë 05.08.2021, duke shtyrë afatin e derogimit të përcaktuar në këto vendime, për një periudhë 24 muaj deri më 05.08.2025, për secilin; si dhe marrja në konsideratë të kërkesës së shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.)” për kualifikimin e HEC-ve të Kaskadës së Lumit Drin (HEC Vau i Dejës, HEC Koman dhe HEC Fierzë).

Për t’u azhornuar në mënyrë më të detajuar mbi vendimet e marra nga ERE, regjistrin e ankesave, regjistrin e licencimeve, transparencën apo informacione të tjera, shfletoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al.